



**BASHKIA  
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA TIRANË**

**ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE**

**“RIOPTIMIZIMI DHE STANDARTIZIMI I PROCESVE TË PUNËS TË STRUKTURËS SË  
INSTITUCIONIT TË BASHKISË TIRANË”**

**Tiranë 2022**

## 1. HYRJE

Bashkia e Tiranës është një institucion në përballje të vazhdueshme me ndryshime dinamike, zhvillimore, teknologjike dhe të normave dhe legjislacioneve përkatëse. Optimizimi dhe Standartizimi i Proceseve të Punës së strukturave të stafit të saj është e domosdoshme të kryhet në periudha të caktuara. BT ka kryer deri në këtë moment një evidentim të shumicës së proceseve të punës të cilat janë përkthyer në struktura konkrete me të cilat operon. Me qëllim për të patur një streamline sa më të saktë të proceseve të punës së institucionit dhe që këto procese të funksionojnë gjithmonë për të patur një efikasitet maksimal në kryerjen e punës dhe në ofrimin e një shërbimi sa më cilësor të qytetarëve të Bashkisë Tiranë. Eficenca ka një impakt të drejtëpërdrejtë mbi produktivitetin e punonjësve që do të përdorin këto procese. Nëpërmjet përmirësimit të tyre dhe rioptimizimit kërkohet të maksimizohet struktura me të cilën funksionon institucioni i BT dhe në të njëjtën kohë të trajnohen stafet që i përdorin këto procese, të rritet efikasiteti organizativ duke i përmirësuar këto procese nëpërmjet eliminimit të proceseve që zgjasin shërbimet në kohë, mirëpërcaktimin e workflowit të punës, përmirësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive dhe parashikimin e ndryshimeve. Në të njëjtën kohë nëpërmjet këtij lloji standartizimi synohet të arrihen përafrimet me Standartet e Bashkimit Europian dhe përcaktimin e të gjitha elementëve ligjorë që mund të kenë nevojë për përmirësim.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 2.1 Objektivi i përgjithshëm

Objekti i këtij projekti është rioptimizimi dhe standartizimi i proceseve të punës së strukturës së Bashkisë Tiranë përmes vlerësimit të procesve aktuale, përmirësimit të menaxhimit të procesve, certifikimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë si dhe trajnimi për këtë sistem të menaxhimit të cilësisë së stafit të Bashkisë Tiranë.

### 2.2 Qëllimi

Qëllimi i këtij shërbimi është identifikimi dhe përmirësimi i procedurave të brendshme, cilësisë së shërbimit dhe krijimit të sistemeve për mbikqyrje të vazhdueshme të veprimeve korrigjuese. Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Procesit dhe Menaxhimit të Cilësisë dhe Trajnimi për përmirësimin e procesit dhe interpretimi i kërkesave të ISO 9001.

Nëpërmjet këtij projekti synohet realizimi dhe rikonfirmimi i një baze të mirëpërcaktuar standardesh të procesve të punës së Bashkisë Tiranë., të tilla si:

- Vlerësimi aktual bazuar në standardet të caktuara që të pasqyrohen rreziqet, rrisqet, dhe dëmet e mundshme si pasojë e mosfunksionimit si duhet të procesit të menaxhimit të Cilësisë;

- Të bëhen update politikat dhe strategjitë e Procesit të Menaxhimit të Cilësisë së Institucionit
- Të realizohet Certifikimit në vazhdimësi për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001
- Të Realizohet Analiza Gap dhe procesi i plotë për KPI konform rregullave të vendosura në Institucion

#### a.Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Kryerja e analizës fillestare GAP të procedurave dhe dokumentacionit ekzistues dhe kërkesave të standardit ISO 9001

- Zhvillimi i një plani veprimi bazuar në rezultatet e analizës së GAP
- Përgatitja/rishikimi i të gjithë dokumentacionit të kërkuar për ISO-n respektive bazuar në planin e veprimit
- Të trajnojnë në seminare ndërgjegjësimi ISO për personat përkatës

Për të arritur këtë qëllim duhet të realizohet procesi në tre faza të rëndësishme të përcaktuara si më poshtë:

#### *FAZA 1*

#### *VLERËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË PROCESIT DHE MENAXHIMIT TË CILËSISË*

##### Aktivitetet

1.1 Përgatitja e një metodologjie për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;

Metodologjia për vlerësimin e nivelit të Menaxhimit të Procesit dhe Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, duhet të përfshijë të gjitha aspektet domethënëse të problematikave të mundshme dhe hapësirën për përmirësime të sistemit ekzistues të menaxhimit.

Metodologjia për të vlerësuar se në çfarë niveli është Menaxhimi i Proceseve dhe Sistemi i Menaxhimit të cilësisë së Institucionit të Bashkisë Tiranë duhet të përfshijë çdo aspekt sinjifikativ të një rëndësie të veçantë duke studiuar të gjitha pikat e

mundshme të dobta të këtij procesi si dhe hapsirat potenciale për përmiresim të sistemit aktual të menaxhimit të proceseve.

Metodologjia duhet të fillojë si më poshtë vijon:

- a) Analiza e nivelit të menaxhimit të palëve të interesuara, nivelit të lartë të menaxhimit në funksionalitetet e Bashkisë Tiranë, e më tej të zbres në nivelet e tjera në Institucion;
- b) Lidhja e pikës a me praktikën e menaxhimit të procesit duke përcaktuar kufijtë dhe fushën e tij të veprimit;
- c) Në vijim të gjithë procesit të identifikimit të menaxhimit të sistemit të cilesisë, të gjithë lidhjet dhe qëllimin final është e domosdoshme të definohet një qasje dhe një vlerësim të nivelit në të cilën ndodhen punonjësit e Bashkisë Tiranë sa i takon organizimit të menaxhimit të proceseve;
- d) Përcaktimi në çfarë niveli këto procese janë të inkuorpuara në proceset e sistemit të menaxhimit të integruar në praktikën ekzistuese të menaxhimit në të gjitha nivelet e administratës së Bashkisë Tiranë;
- e) Metodologjia e kërkuar gjithashtu do të përcaktoj përgjegjësitë për të gjithë proceset e punës ditore/rutinore të Bashkisë Tiranë, nivelet e kërkuara dhe të definuara për të arritur indikatorët e nivelit optimal të një menaxhimi të sukseshëm procesesh.

1.2 Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të procesit dhe menaxhimit të cilësisë sipas metodologjisë së përcaktuar;

Është e nevojshme krijimi i një plani i cili do të përmbajë propozimin me datën për një vizitë tek të gjithë njësitë organizative.

Plani duhet të mbulojë të gjithë njësitë e Bashkisë Tiranë. Për çdo pjesë organizacionale të mbuluara nga njësitë në planin e kaluar duhet planifikuar një vizitë e dytë duke përcaktuar të gjitha detyrat e reja që do të duhet të kryejnë.

Plani operacional duhet të aprovohet nga strukturat e drejtimit të lartë të Bashkisë Tiranë dhe do të dërgohet tek personi përgjegjës në Institucionin e Bashkisë Tiranë të paktën 10 ditë përpara vizitës së planifikuar.

1.3 Krijimi i raportit me problematikat e identifikuara dhe rekomandime për trajnime për përmirësimin e procesit;

Raporti duhet të bëhet për secilën njësi/ organizatë më vete. Bazuar në raport, është e nevojshme të përgatitet një prezantim i duhur për ekipin menaxhues të institucionit.

*FAZA 2:*

*TRAJNIMI PËR PËRMIRËSIMIN E PROCESIT DHE INTERPRETIMI I KËRKESAVE TË ISO 9001*

Aktivitetet

2.1 Krijimi i një plani trajnimi gjithëpërfshirës;

Bazuar në raportin e prezantuar dhe të miratuar, është e nevojshme të hartohet një program dhe plan i detajuar trajnimi për të përmirësuar procesin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

- Programi i trajnimit duhet të përfshijë një bazë teorike dhe shembuj praktikë.
- Programi i trajnimit duhet të përfshijë workshops me grupe që do të formohen dhe emërohen nga Bashkia Tiranë.
- Trajnimet e ekipit workshop duhet të realizohen në nivelin e kërkuar në mënyrë që të realizohen të gjitha përmirësimet e nevojshme në përputhje me raportin e lëshuar nga faza 1.

2.2 Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit - DMAIC (Përcakto, Mat, Analizo, Përmirëso dhe Kontrolllo) me një kohëzgjatje minimale prej:

- 4 orësh për Lean Six Sigma White Belt;
- 8 orë për Lean Six Sigma Yellow Belt;
- 24 orë për Lean Six Sigma Green Belt dhe ;
- 40 orë Lean Six Sigma Black Belt.

Pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe kalimit të provimit me shkrim ofertuesi i shërbimit është i detyruar t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve në trajnim;

2.3 Trajnim për vlerësimin e përmirësimeve duke përdorur Treguesit Kyç të Performancës (KPI) të lidhur me drejtuesit e Insitucionit të Bashkisë Tiranë me një kohëzgjatje minimale prej 16 orësh.

Pas perfundimit me sukses të trajnimit dhe kalimit të provimit me shkrim ofertuesi i shërbimit është i detyruar t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve në trajnim;

2.4 Interpretimi i kërkesave ISO 9001 me kohëzgjatje minimale 16 orë;

Aktivitetet specifike ISO 9001

- Zhvillimi i politikës së cilësisë
- Përcaktimi qëllimeve e kualitetit
- Përcaktimi i fushës së sistemit të menaxhimit të cilësisë
- Kryerja e vlerësimit të supplier
- Kryerja analiza të rrezikut të cilësisë

2.5 Trajnim me ushtrime praktike se si të zbatohen kërkesat e ISO 9001 në organizatë me një kohëzgjatje minimale prej 40 orësh;

- Trajnimi duhet të zhvillohet në formë leksionesh dhe ushtrimesh në të cilat të gjithë pjesëmarrësit do të kenë rol aktiv dhe do të zgjidhin problemet praktike që lidhen me pozicionin dhe detyrat e tyre të përditshme.
- Trajnimi duhet të realizohet përmes leksioneve interaktive me pjesën teorike dhe praktike të paraqitur nga Ofertuesi me përfshirjen e të trajnuarve në diskutim.
- Ushtrimet duhet të bazohen në raste studimore të zgjedhura posaçërisht për aktivitetet dhe problematikat që të trajnuarit hasin çdo ditë. Nga rasti në rast, çështjet do të zgjidhen individualisht ose në ekip dhe çdo çështje do të përfundojë me konsensus diskutimi.
- Koha e trajnimeve çdo ditë do të planifikohet në atë mënyrë që t'u lihet kohë të mjaftueshme kursantëve për të shprehur problemet dhe çështjet konkrete.

2.6 Trajnimi i auditorëve të brendshëm me një kohëzgjatje minimale prej 24 orësh.

- Pas perfundimit me sukses të trajnimit dhe kalimit të provimit me shkrim ofertuesi është i detyruar t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve në trajnim;

## 2.7 Krijimi i raportit të vlerësimit të trajnimit;

- Raporti do të shikojë rezultatet e arritura gjatë trajnimit. Gjatë gjithë trajnimit lektorët do të ndjekin dhe shënojnë të gjitha faktet e rëndësishme në lidhje me njohuritë e menaxhmentit, aktivitetin e tyre gjatë trajnimit, shkallën e përvetësimit të njohurive të reja, motivimin, etj. mbi atë se çfarë do të përmbajë raporti i plotë duke parë këto parametra para dhe pas trajnimit të kryer.
- Raporti do të përbëhet nga faqosja e të gjithë projektit, shkalla e përmbushjes së qëllimeve të vendosura, problemet që kanë ndodhur gjatë trajnimit dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

### **FAZA 3:**

#### ***CERTIFIKIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË***

3.1 Kryerja e auditimit të certifikimit në përputhje me ISO 9001:2015 për të gjitha organizatat/agjensite e varesise te Bashkise Tirane te perfshira ne këtë projekt

Mënyra dhe afati i kryerjes së shërbimeve:

Shërbimet e trajnimit dhe certifikimit në fushën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë do të kryhen ekskluzivisht në bazë të kërkesës me shkrim të Institucionit të Bashkisë Tiranë, në mënyrë të njëpasnjëshme, sipas nevojave të Institucionit (kërkesë me shkrim nënkupton kërkesën e paraqitur me e-mail ose faks).

Afati dhe dinamika e kryerjes së shërbimeve në fushën e SMC janë renditur në Tabelen 1.

<b>Përshkrimi i Shërbimit</b>	<b>Afati per kryerjen e shërbimit</b>	<b>Sasia e përafërt</b>
<b><i>Faza 1: Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Procesit dhe Menaxhimit të Cilësisë</i></b>		
Përgatitja e një metodologjie për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë	Jo më shumë se 30 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	1
Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të procesit dhe menaxhimit të cilësisë sipas metodologjisë së përcaktuar	Jo më shumë se 60 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	1

Krijimi i raportit me dobësi të identifikuar dhe rekomandime për trajnime për përmirësimin e procesit	Jo më shumë se 30 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	1
<b><i>Faza 2: Trajnimi për përmirësimin e procesit dhe interpretimi i kërkesave të ISO 9001</i></b>		
Krijimi i një plani trajnimi gjithëpërfshirës	Jo më shumë se 15 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	1
Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit - DMAIC (Përcaktoni, Matni, Analizoni, Përmirësoni dhe Kontrolloni)	Jo më shumë se 90 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	Punonjësit e përzgjedhur
Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit - DMAIC (Përcaktoni, Matni, Analizoni, Përmirësoni dhe Kontrolloni)  Trajnim për matjen e përmirësimeve duke përdorur Treguesit Kryesor të Performancës (KPI) të lidhur me drejtuesit e biznesit	Jo më shumë se 15 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	Punonjësit e përzgjedhur
Interpretimi i kërkesave të ISO 9001	Jo më shumë se 90 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	Punonjësit e përzgjedhur
Trajnim me ushtrime praktike se si të zbatohen kërkesat e ISO 9001 në organizatë	Jo më shumë se 60 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	Punonjësit e përzgjedhur
Trajnimi i auditoreve të brendshëm	Jo më shumë se 15 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	Punonjësit e përzgjedhur
Krijimi i raportit të vlerësimit të trajnimit	Jo më shumë se 15 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga	1



	Bashkia Tiranë	
<b>Faza 3: Certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë</b>		
Kryerja e auditimit të certifikimit në përputhje me ISO 9001:2015	Jo më shumë se 30 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga Bashkia Tiranë	3-4*

\* Në varësi të numrit të pjesemarrësve që do të përfshihen në projekt

**Sasia e përafërt** - sasi të pritshme për ekzekutimin e shërbimit. Sasitë përfundimtare do të përcaktohen në përputhje me nevojat e Institucionit të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesës me shkrim të AK dhe brenda vlerës së parashikuar të procedurës së prokurimit.

➤ Përshkrimi i detyrës

Operatori ekonomik fitues duhet të ketë parasysh:

- Të performohet një Current Evaluation
- Të përpilohen raportet përkatëse mbi gjetjet gjatë dhe në fund të procesit të Evaluimit/Vleresimit
- Të merren masat mbi gjetjet gjatë procesit të testimit
- Të ofrojë certifikimin për ISO 9001 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, për Institucionin e Bashkisë Tiranë
- Përgatitjen për vlerësimin e konformitetit të ofruesit të shërbimeve të besuara
- Kryerja e analizës së GAP dhe zhvillimi i planit të veprimit bazuar në rezultatet e analizës
- Krijimi ose përditësimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për certifikimin ISO
- Kryerja e analizës së rrezikut
- Kryerja e auditimit të brendshëm
- Kryerja e rishikimit të menaxhimit
- Trainimi i Punonjesve
- Certifikimi

➤ Hapësira gjeografike që do të mbulohet

- Bashkia Tiranë dhe Institucionet e Varësisë:

Ky proces do të kryhet për Bashkinë Tiranë dhe disa prej insitucioneve të saj të varësisë si më poshtë:

1. Bashkia Tiranë - Aparati Qendror
2. Policia Bashkiake
3. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit
4. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
5. Tirana Parking
6. Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorëve
7. Agjensia e Shëbimeve Funerale
8. Agjensia e Adminstrimit të Tregjeve

### 3. KËRKESA SPECIFIKE PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT

#### a. Çertifikime

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë përvojë të mëparshme në certifikimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë duke u bazuar në kërkesat e standartit ISO 9001:2015 në të paktën 3 (tre ) organizata me kodin (EA36);
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë certifikatë akreditimi për qëllimin ISO CERTIFICATION për “Administratën Publike” (kodi EA36) lëshuar nga një Trupë Certifikuese, pjestare e “The International Accreditation Forum” (IAF).

#### b. Staf dhe eksperiencia


Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar, të paktën 3 (tre) persona staf me eksperiencë pune prej mbi 3 vite nga të cilët të paktën njëri duhet të zotërojë certifikimet e mëposhtme:

1. Të ketë përfunduar studimet akademike Master në fushën e Menaxhimit të Cilësisë apo e ngjashme me të;
2. Të zotërojë një certifikatë të akredituar për Lead Implementer të ISO 9001 (Certified ISO 9001 Lead Implementer);
3. Të zotërojë një certifikatë të akredituar për Lead Auditor për ISO 9001 (Certified ISO 9001 Lead Auditor);
4. Të zotërojë një certifikatë Lean Six Sigma Black Belt ose ekuivalente;
5. Të jetë i certifikuar si KPI Practitioner;
6. Të ketë zbatuar të paktën 5 (pesë) projekte të përmirësimit të proceseve të biznesit ose përmirësimit të organizatës, nga të cilat të paktën 3 (tre) projekte të jenë në sektorin publik ose administratën publike, të vërtetuara nga institucionet/dhe ose kontratë që ka qenë pjesëmarrës/se në projektet e sipërpermendura;
7. 1 (një) Ekspert si menaxher i cilësisë i organizmit inspektues sipas certifikatës së akreditimit, me të paktën 10 (dhjetë) eksperiencë si specialist/ auditues ose ekuivalent me standartin *ISO 9001* në fushën e menaxhimit të cilësisë.

## ➤ Detyrat specifike

Operatori ekonomik fitues gjatë kësaj procedure duhet të realizojë keto detyra:

- ✚ Faza I: Analizimi i kërkesave dhe bazës ligjore. Kjo faze është faza përgatitore ku operatori ekonomik fitues do të bëjë një analizë të plotë të gjendjes aktuale dhe gjitha procedurave administrative.
- ✚ Faza II: Në këtë fazë do të realizohen të gjitha kërkesat të cilat janë pjesë e këtij projekti, si:
  - Të performohet një Current Evaluation për situatën
  - Të përpilohen raportet përkatëse mbi gjetjet gjatë dhe në fund të procesit të Evaluimit/Vleresimit.
  - Të merren masat mbi gjetjet gjatë procesit të testimit.
  - Të ofrojnë certifikimin në vazhdimësi për Menaxhimi i shërbimit, ISO 9001 Sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe auditimi
  - Kryerja e analizës së GAP dhe zhvillimi i planit të veprimit bazuar në rezultatet e analizës
  - Krijimi ose përditësimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për certifikimin ISO-se
  - Kryerja e analizës së rrezikut
  - Kryerja e auditimit të brendshëm
  - Kryerja e Trainimit për stafin
- ✚ Faza III: Në këtë fazë duhet t'i dorëzohen Bashkise Tirane të gjitha dokumentacionet e përpunuara mbi performancën, analizat e riskut, raportet, etj.



Detyrat specifike për standardet ISO do të ndjekin të njëjtën metodologji implementimi si në figurë.

#### 4. LOGJISTIKA DHE KOHA

##### a. Vendndodhja

Tiranë, Bashkia Tiranë

##### b. Data e fillimit dhe periudha e implementimit të detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 12 muaj.

#### 5. RAPORTIMI

##### a. Kërkesat e raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal dhe dy kopje:

- **Raporti Fillestar** duhet të prodhohet brenda javës së katërt nga data e fillimit të implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç

programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar

- **Raport mbi vlerësimin e gjendjes Aktuale**

Në raport do të përfshihet një përmbledhje ekzekutive ku analizohet gjendja e kontrolleve aktuale.

- **Raport mbi Remediation plan**

Në raport do të përfshihen masat aktuale që duhet të ndërmerren për zbatimin e përmirësimeve mbi vulnerabilitetet e gjetura.

- **Raport për standardet ISO**

Kto raporte mund të jenë dhe pjese e raportit perfundimtar të auditit për secilin standard

#### b. Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

Raportet e përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

### 6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Jo e zbatueshme

### 7. GARANCIA

Jo e zbatueshme

### 8. MIRËMBAJTJA

Jo e zbatueshme

### 9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr	Emërtimi/Përshkrimi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Vlera
<b><i>1. Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Procesit dhe Menaxhimit të Cilësisë</i></b>				
1.1	Përgatitja e një metodologjie për menaxhimin e procesit dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë	1		
1.2	Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të procesit dhe menaxhimit të cilësisë sipas metodologjisë së përcaktuar	1		
1.3	Krijimi i raportit me dobësi të identifikuara dhe rekomandime për	1		

	trajtime për përmirësimin e procesit			
<b>2. Trajnimi për përmirësimin e procesit dhe interpretimi i kërkesave të ISO 9001</b>				
2.1	Krijimi i një plani trajnimi gjithëpërfshirës	1		
2.2	Trajnim për Metodologjinë e Përmirësimeve të Procesit	1		
2.3	Trajnim për matjen e përmirësimeve duke përdorur Treguesit Kryesor të Performancës (KPI) të lidhur me drejtuesit e institucionit	1		
2.4	Interpretimi i kërkesave të ISO 9001	1		
2.5	Trajnim me ushtrime praktike se si të zbatohen kërkesat e ISO 9001 në organizatë	1		
2.6	Trajnimi i auditoreve të brendshme	1		
2.7	Krijimi i raportit të vlerësimit të trajnimit	1		
<b>3. Certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë</b>				
3.1	Kryerja e auditimit të certifikimit në përputhje me ISO 9001:2015	1		
<b>Çmimi NETO</b>				
<b>TVSH 20 %</b>				
<b>Çmimi TOTAL</b>				

Punoi: Grupi i punës ngritur sipas Urdhrit të titullarit të AK-së “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit me objekt “Rioptimizimi dhe Standartizimi i Proceseve të punës të strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë”.

## GRUPI I PUNES

-Fund-